REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASENIT LUMOR VJOSË

Nr. 65/16 prot.

Vlorë, më 27.11.2025

VENDIM

Nr. 11 , datë 14.11.2025

PËR

MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR UJË TË PIJSHËM, TË SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME VLORË, ME VENDNDODHJE: PUSI NR.5, NOVOSELË.

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, "Për Burimet Ujore", i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, *"Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre"*, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Vjosë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor nëntokësorë për ujë të pijshëm (sisteme të furnizimit me ujë të popullatës) në rastin kur përdorimi është > 1 l/sek, të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë, me vendndodhje: Pusi Nr. 5, Novoselë, Vlorë.

2. Treguesit paraprakë janë si më poshtë:

   Vendndodhja e burimit (KRGJSH):

   X= 455052.89 Y= 4498796.66 Z=5.5 m.m.n.d

   Sasia e ujit të kërkuar: Q_{llog} = 55 l/sek

   Lloji aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji. Furnizimi me ujë i Aeroportit të Vlorës.

- Përpara fillimit të shfrytëzimit të ujit për qëllimin e kërkuar, të merren masat përkatëse të dezinfektimit dhe trajtimit përkatës të tij në përputhje me VKM-në Nr. 379, datë 25.05.2016 "Cilësia e Ujit të Pijshëm", sipas shkresës Nr.2864 prot., datë 06.10.2025 të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë;
- Të merren masat përkatëse për sigurimin e zonës së mbrojtjes sanitare të pus-shpimit;

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.

KRYETARI I KBL VJOSË

EVIS ALLUSHI